



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR 06/2022 PËR MËNYRËN E DHËNIES¹
DHE PROGRAMIN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoJ-NO 06/2022 ON THE MANNER OF²
PASSING AND THE PROGRAM OF BAR EXAMINATION**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MP-BR 06/2022 O NAČINU POLAGANJA³
I PROGRAMU ZA POLAGANJE PRAVOSUDNOG ISPITA**

¹ Udhëzim Administrativ MD-nr 06/2022 për mënyrën e dhënies dhe programin e provimit të jurisprudencës, i nënshkruar nga Ministri e Drejtësisë, më datë 14.11.2022.

² Administrative Instruction MoJ-no 06/2022 on the manner of² passing and the program of bar examination, signed by Minister of Justice, date 14.11.2022.

³ Administrativno Uputstvo MP - br 06/2022 o načinu polaganja i programu za polaganje pravosudnog ispita, je potpisano od strane Ministar Pravde, datum 14.11.2022.

<p>Ministri i Ministrisë së Drejtësisë,</p> <p>Në mbështetje të nenit 11 të ligjit Nr. 08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës, (GZ, NR. 16 me datë 4 korrik 2022) duke u bazuar në nenin 8 nënparagrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 04/2021 dhe Rregulloren (QRK) nr. 03/2022, si dhe nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerrë:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR 06/2022 PËR MËNYRËN E DHËNIES DHEPROGRAMIN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS</p> <p>Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi</p> <p>Me këtë udhëzim përcaktohet mënyra e dhënies së provimit të jurisprudencës (tutje provimi), mënyra e paraqitjes së provimit, puna e komisionit për dhënien e provimit (tutje: Komisioni), Programi i provimit,</p>	<p>The Minister of the Ministry of Justice,</p> <p>Pursuant to article 11 of Law No. 08/L-033 on Bar Examination (OG, NR. 16, dated 4 July 2022) based on article 8 subparagraph 1.4 of Regulation No. 02/2021 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, as amended and supplemented by Regulation No. 04/2021 and Regulation (QRK) no. 03/2022 as Article 38 paragraph 6 of the Rules of Procedure of the Government of the Kosovo No. 09/2011 (Official Gazette no. 15, 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoJ-NO 06/2022 ON THE MANNER OF PASSING ANDTHE PROGRAM OF BAR EXAMINATION</p> <p>Article 1 Purpose and Scope</p> <p>This instruction determines the manner of passing the bar examination (hence: the examination), applying for the exam, the task of the bar examination commission (hence: the Commission), examination program,</p>	<p>Ministar Ministarstva pravde,</p> <p>Na osnovu člana 11. Zakona br. 08/L-033 o polaganju pravosudnog ispita (SL, BR. 16, dana jul 4 2022),pozivajući se na član 8. podstav 1.4 Uredbe br. 02/2021 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, izmenjena i dopunjena Uredbom br. 04/2021 i Uredbe (KRK) br. 03/2022, i na osnovu člana 38. stav 6. Poslovnika o radu Vlade Kosovo br. 09/2011 (Službeni glasnik br. 15, 12.09.2011),</p> <p>Donosi:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVOMP-BR 06/2022 O NAČINU POLAGANJA I PROGRAMU ZA POLAGANJE PRAVOSUDNOG ISPITA</p> <p>Član 1 Svrha i delokrug važenja</p> <p>Ovim Uputstvom utvrđuju se način polaganja pravosudnog ispita (dalje u tekstu: ispit), način prijavljivanja ispita, rad ispitne komisije (dalje u tekstu: komisija), program ispita, sadržaj zapisnika, uverenje</p>
---	--	--

<p>përmbajtja e procesverbalit, përmbajtja e Certifikatës për dhënien e provimit, përmbajtja e evidencës për provimin e dhënë të jurisprudencës dhe mbrojtja e të drejtave të kandidatit.</p>	<p>transcript, examination pass certificate, content of the evidence on passing the bar examination and the protection of candidate's rights.</p>	<p>o položenom pravosudnom ispitu, sadržaj evidencije o polaganju pravosudnog ispita i zaštita prava kandidata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Programi i provimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Examination Program</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Program ispita</p>
<p>1.Programi i provimit përfshinë lëndët si në vijim:</p>	<p>1.The examination program includes the subjects as follows:</p>	<p>1.Program ispita obuhvata predmete kao sledeće:</p>
<p>1.1. E drejta penale (materiale dhe procedurale);</p>	<p>1.1.Criminal Law (substantive and procedural);</p>	<p>1.1.krivično pravo (materijalno i procesno);</p>
<p>1.2. E drejta civile (materiale dhe procedurale);</p>	<p>1.2.Civil Law (substantive and procedural);</p>	<p>1.2.građansko pravo (materijalno i procesno);</p>
<p>1.3. E drejta kushtetuese dhe bazat e sistemit gjyqësor;</p>	<p>1.3. Constitutional Law and foundations of judicial system;</p>	<p>1.3.ustavno pravo i osnovi pravosudnog sistema;</p>
<p>1.4. E drejta tregtare, e drejta e punës dhe e drejta administrative;</p>	<p>1.4. Commercial Law, Labor Law and Administrative Law;</p>	<p>1.4.trgovinsko (privredno) pravo, radno pravo i upravno pravo;</p>
<p>1.5. E drejta ndërkombëtare (private dhe publike) dhe e Drejta e Bashkimit Evropian.</p>	<p>1.5. International Law (private and public) and European Union Law.</p>	<p>1.5. međunarodno (privatno i javno) pravo i pravo Evropske unije.</p>
<p>2.Programi i provimit është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ (Shtojca 1).</p>	<p>2.The examination program is an integral part of this Administrative Instruction (Annex 1).</p>	<p>2.Program ispita je sastavni deo ovog Administrativnog uputstva (Dodatak 1).</p>
<p>3.Me rastin e ndryshim plotësimit apo</p>	<p>3. By amending-supplementing or repealing</p>	<p>3. Prilikom izmene, dopune ili ukidanja</p>

<p>shfuqizimit të ligjeve të listuara në Shtojcën 1 të këtij Udhëzimi, ndryshohet dhe plotësohet pjesa përkatëse e programit të Provimit në Shtojcën 1 të këtij Udhëzimi.</p> <p>4.Për ndryshim plotësimin e Shtojcës 1 sipas paragrafit 3 të këtij neni, Ministri i Ministrisë së Drejtësisë nxjerr vendim.</p> <p>5. Detyrat në provim me shkrim dhe pyetjet në provim me gojë, duhet të jenë të bazuara në programin për dhënien e provimit të jurisprudencës sipas shtojcës 1 të këtij Udhëzimi.</p>	<p>the laws listed in Annex 1 of this Instruction, the relevant part of the Examination program in Annex 1 of this Instruction is also amended-supplemented.</p> <p>4.The Minister of Justice shall issue a decision on amending-supplementing Annex 1, in accordance with paragraph 3 of this Article.</p> <p>5.The written exam assignments and oral exam questions should be based on the program for the bar exam according to the Annex 1 of this Instruction.</p>	<p>zakona navedenih u Prilogu 1. ovog uputstva, izmenjuje i dopunjuje se relevantni deo programa Ispita iz Priloga 1. ovog uputstva.</p> <p>4. Za izmenu i dopunu Priloga 1 prema stavu 3 ovog člana, Ministar pravde donosi odluku.</p> <p>5. Zadaci na pismenom ispitu kao i pitanja na usmenom ispitu, trebaju da se zasnivaju na programu za polaganje pravosudnog ispita prema prilogu 1 iz ovog Uputstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Kushtet për dhënien e provimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Terms for Passing the Examination</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Uslovi za polaganje ispita</p>
<p>Personi i cili përmbush kushtet e përcaktuara me nenin 8 të Ligjit Nr. 08/L-033 Për Provimin e Jurisprudencës (tutje Ligji), mund të dorëzoj kërkesën për dhënien e provimit në Ministrinë e Drejtësisë (tutje: Ministria).</p>	<p>The person who meets the criteria determined by Article 8 of the Law No.08/L-033 on Bar Examination (hence: the Law) may submit at the Ministry of Justice (hereinafter: the Ministry) the request to enter the exam.</p>	<p>Lice koje ispunjava uslove utvrđene u členu 8. Zakona br.08/L-033 o pravosudnom ispitu (dalje u tekstu: Zakon) može da podnese zahtev za polaganje ispita Ministarstvu pravde (u daljem tekstu: Ministarstvo).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Procedura e Aplikimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Application procedure</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Postupak za prijavljivanje</p>
<p>1. Ministria publikon shpalljen për aplikim për provimin në ueb faqen zyrtare të Ministrisë, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para mbajtjes së provimit.</p>	<p>1. The Ministry publishes the announcement for applications for the examination on the official website of the Ministry, no later than thirty (30) days before the examination is conducted.</p>	<p>1. Ministarstvo objavljuje oglas sa pozivom za dostavljanje prijava za ispit na zvaničnoj internet stranici Ministarstva, ne kasnije od trideset (30) dana pre održavanja ispita.</p>

<p>2.Kërkesës për dhënie e provimit, kandidati ia bashkëngjet dokumentet e vërtetuara me të cilat dëshmon se i plotëson kushtet ligjore që ti nënshtrohet provimit.</p> <p>3.Kandidati në kërkesë zgjedh gjuhën zyrtare në të cilën do t'i nënshtrohet provimit dhe po ashtu kërkesa duhet të përmbaj njoftimin nëse kandidati i është nënshtrohet provimit më parë.</p> <p>4.Komisioni përkatës i Ministrisë për lejimin e dhënies së provimit (tutje: Komisioni përkatës) shqyrton të gjitha kërkesat e dorëzuara dhe me vendim përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënie e provimit.</p> <p>5.Kundër vendimit të Komisionit përkatës, kandidati mund të paraqes ankesë Ministrisë në pajtim me nenin 12 paragrafi 5 të Ligjit.</p>	<p>2. The candidate attaches verified documents to the request to enter the examination which prove that legal requirements for entering the examination are met.</p> <p>3. In the request, the candidate chooses the official language in which he/she will enter the examination and the request also shall contain the note whether the candidate has entered the examination before.</p> <p>4. The respective committee of the Ministry for granting the right to enter the examination (hence: the respective Commission) reviews all submitted requests, and by means of a decision, determines if the candidate meets the requirements for entering the bar examination.</p> <p>5.Against the decision of the relevant Commission, the candidate can submit a complaint to the Minister in accordance with Article 12 paragraph 5 of the Law</p>	<p>2. Uz zahtev za polaganje ispita kandidat treba da priloži overene dokumente kojima dokazuje da ispunjava zakonske uslove da polaže ispit.</p> <p>3. Kandidat u svom zahtevu bira službeni jezik na kojem će da polaže ispit, a pored toga zahtev treba da sadrži i obaveštenje da li je kandidat ranije već polagao ispit.</p> <p>4.Nadležna komisija Ministarstva za odobravanje polaganja ispita (u daljem tekstu: nadležna komisija) razmatra sve predate zahteve i svojom odlukom utvrđuje da li kandidat ispunjava uslove za polaganje ispita.</p> <p>5.Protiv odluke nadležne komisije kandidat može podneti žalbu ministru u skladu sa članom 12. stav 5. Zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Përmbajtja e kërkesës për dhënie e provimit</p> <p>1.Kërkesa për lejimin e dhënies së provimit të jurispruencës përmban të dhënat për</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Content of the request for entering the examination</p> <p>1. The request to grant entry of the bar examination contains the data for the</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Sadržaj zahteva za polaganje ispita</p> <p>1.Zahtev za dozvolu polaganjapравосудног ispita sadrži podatke o licu koje je podnelo</p>

<p>personin i cili paraqet kërkesën, dhe atë:</p> <p>1.1.emrin, emrin e babait dhe mbiemrin;</p> <p>1.2.data dhe vendi i lindjes;</p> <p>1.3.pozita dhe vendi i punës.</p> <p>2.Kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni i bashkëngjiten edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara sipas nenit 8 të Ligjit:</p> <p>2.1. kopja e vërtetuar e diplomës së Fakultetit Juridik;</p> <p>2.2.vërtetimi për përvojën e punës;</p> <p>2.3.Certifikaten e shtetësisë.</p> <p>3.Kërkesa për lejimin e dhënies së provimit të jurisprudencës përmban datën e parashtrimit të kërkesës dhe nënshkrimin e aplikuesit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Komisioni për lejimin e dhënies së provimit</p> <p>1.Komisioni përkatës emërohet me vendim nga Ministri i Drejtësisë (tutje: Ministri).</p>	<p>person filing the request, and that:</p> <p>1.1.name, father's name and surname;</p> <p>1.2.date and place of birth;</p> <p>1.3.position and work place.</p> <p>2.Evidence on fulfilling the conditions foreseen by Article 8 of the Law is attached to the request from paragraph 1 of this article:</p> <p>2.1.a verified copy of Law School diploma;</p> <p>2.2.attestation of work experience;</p> <p>2.3. Citizenship certificate.</p> <p>3.The request to grant entering the bar examination contains the date of request filing and the signature of the applicant.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 The committee on granting entry in the exam</p> <p>1. The respective committee is appointed with a decision of the Minister of Justice (hence: the Minister).</p>	<p>zahtev, i to:</p> <p>1.1.ime, ime oca i prezime;</p> <p>1.2.datum i mesto rodenja;</p> <p>1.3.poziciju i radno mesto.</p> <p>2. Uz zahtev iz stava 1. ovog člana treba priložiti dokaze o ispunjavanju uslova propisanih u članu 8. Zakona:</p> <p>2.1.overenu kopiju diplome pravnog fakulteta;</p> <p>2.2.uverenje o radnom iskustvu;</p> <p>2.3. uverenje o državljanstvu.</p> <p>3.Zahtev za dozvolu polaganja pravosudnog ispita sadrži datum podnošenja zahteva i potpis podnosioca zahteva.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Komisija za dozvolu polaganja ispita</p> <p>1. Nadležna komisija imenuje se odlukom ministra pravde (dalje u tekstu: Ministar).</p>
---	--	---

<p>2. Komisioni përkatës përbëhet nga tre (3) anëtarë, me mandat në kohëzgjatje prej 2 vite.</p> <p>3. Anëtarët e Komisionit caktohen nga radhët e nëpunësve civil të Ministrisë.</p> <p>4. Komisioni përkatës nga paragrafi 1 i këtij neni, i takon kompensimi për punë jashtë orarit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p>	<p>2. The respective committee is composed of three (3) members) with a 2-year mandate.</p> <p>3. Members of the Commission are appointed from the ranks of the civil employees of the Ministry.</p> <p>4. The relevant commission from paragraph 1 of this article who is entitled to compensation for overtime work, in accordance with the relevant legislation in force.</p>	<p>2. Nadležna komisija sastoji se od tri (3) člana, sa mandatom u trajanju od 2 godine.</p> <p>3. Članovi komisije biraju se iz redova državnih službenika u Ministarstvu.</p> <p>4. Odgovarajuća komisija iz stava 1. ovog člana i isti ima pravo na naknadu za prekovremeni rad, u skladu sa relevantnim zakonodavstvom na snazi.</p>
<p>Neni 7 Përgjegjësitë e Komisionit përkatës</p>	<p>Article 7 Responsibilities of the respective commission</p>	<p>Član 7 Odgovornosti nadležne komisije</p>
<p>1. Kryetari i Komisionit përkatës ka këto përgjegjësi:</p> <p>1.1. udhëheq punën e Komisionit përkatës;</p> <p>1.2. thërret takimet e Komisionit përkatës;</p> <p>1.3. nënshkruan vendimin për përcaktimin se kandidati i plotëson apo jo kushtet për dhënien e provimit</p> <p>1.4. përgatit raport përfundimtar për</p>	<p>1. The Chairman of the Commission has the following responsibilities:</p> <p>1.1. steers the work of the respective commission;</p> <p>1.2. convenes the meetings of the respective Commission;</p> <p>1.3. signs the decision on determining whether a candidate meets the conditions for entering the examination</p> <p>1.4. drafts a final report for the reviewed</p>	<p>1. Predsednik Nadležne Komisije ima sledeće odgovornosti:</p> <p>1.1. rukovodi radom nadležne komisije;</p> <p>1.2. saziva sastanke nadležne komisije;</p> <p>1.3. potpisuje odluke kojima se utvrđuje da li kandidat ispunjava uslove za polaganje ispita.</p> <p>1.4. priprema završni izveštaj o</p>

<p>kërkesat e shqyrtuara për lejimin e dhënies së provimit.</p> <p>2. Komisioni merr vendim me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Afati për hyrje në provim</p> <p>1.Ministria e Drejtësisë cakton afatet e provimit të Jurisprudencës.</p> <p>2.Për kohën e dhënies së provimit nga paragrafi 1 i këtij neni, kandidatët do të njoftohen përmes publikimit të njoftimit në ueb faqen zyrtare të Ministrisë, më së paku 10 ditë para datës së caktuar për dhënien e provimit.</p>	<p>requests on granting the entry in the examination.</p> <p>2. The Commission decides on a majority vote of all members of the respective Commission.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Deadline for entering the examination</p> <p>1. The Ministry of Justice sets the dates for the bar examination.</p> <p>2. The announcement concerning the date of entering the examination from paragraph 1 of this article, candidates will be notified through the publication of the announcement on the official website of the Ministry, at least 10 days prior to the set date for entering the examination.</p>	<p>razmatranim zahtevima za odobrenje polaganja ispita.</p> <p>2.Komisija donosi odluke većinom glasova svih članova odnosno komisije</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Rok za pristupanje ispitu</p> <p>1.Ministarstvo pravde određuje rokove za polaganje pravosudnog ispita.</p> <p>2.Obaveštenje o datumu polaganja ispita iz stava 1 ovog člana, kandidati će biti obavješteni kroz objavljivanje saopštenja na službenom sajtu Ministarstva, najmanje 10 dana pre datuma određenog za polaganje ispita.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Shpenzimet</p> <p>1.Kandidati i cili do t'i nënshtrohet provimit është i obliguar t'i bartë shpenzimet për provim.</p> <p>2.Kandidatët në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale të cilët janë shfrytëzues të skemës sociale dhe kandidatët tjerë të cilëve ju njihet e drejta e lirimit nga taksat administrative publike, janë të liruar nga</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Expenditures</p> <p>1.The candidate who shall undergo the examination is required to carry the examination expenditures.</p> <p>2.Candidates of poor economic and social status who are beneficiaries of social assistance and other candidates who are recognized the right of exemption from public administrative taxes, will be exempted</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Troškovi</p> <p>1.Kandidat koji će da polaže ispit obavezan je da snosi troškove polaganja ispita.</p> <p>2.Kandidati u teškoj ekonomskoj i socijalnoj situaciji koji su korisnici šeme socijalne pomoći i drugi kandidati kojima se priznaje pravo na oslobođanje od javnih administrativnih taksi, oslobođaju se od</p>

<p>pagesa e shpenzimeve për dhënien e provimit të jurisprudencës.</p> <p>3.Kandidati duhet të aplikoj për lirim nga shpenzimet.</p> <p>4.Kandidati ofron dëshmi se është përfitues i skemës sociale apo i përket një kategorie që janë të liruar nga pagesa.</p> <p>5.Kandidati lirohet nga pagesa me vendim të ministrit të Drejtësisë, pas shqyrtimit të kërkesave për lirim nga pagesa.</p> <p>6. Lartësinë e shpenzimeve e përcakton me vendim Ministri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Mënyra e mbajtjes së provimit</p> <p>Provimi mbahet me shkrim dhe me gojë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Organizimi i provimit me shkrim</p> <p>1.Provimi me shkrim mbahet nga e drejta penale dhe e drejta civile brenda dy ditëve të njëpasnjëshme.</p> <p>2.Detyrat nga provimi me shkrim i përpilon</p>	<p>from payment for entering the bar examination.</p> <p>3.The candidate must apply for exemption from payment.</p> <p>4.The candidate provides evidence that he/she is beneficiary of a social scheme or belongs to a category that are exempted from payment.</p> <p>5.The candidate is released from payment by decision of the Minister of Justice, after reviewing the requests for exemption from payment.</p> <p>6.The amount of expenditures is determined by a decision of the Minister.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Manners of Taking the Examination</p> <p>The examination is conducted in writing and orally.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Organizing written examination</p> <p>1.The written examination is conducted on criminal law and civil law within two consecutive days.</p> <p>2.Assignment from the written examination is</p>	<p>plaçanja troškova za polaganje pravosudnog ispita.</p> <p>3.Kandidat mora podneti zahtev za oslobođanje od troškova.</p> <p>4.Kandidat prilaže dokaze da je korisnik šeme socijalne pomoći ili da pripada kategoriji koja je oslobođena od plaćanja.</p> <p>5.Kandidat se oslobađa od plaćanja rešenjem ministra pravde, nakon razmatranja zahteva za oslobođanje od plaćanja.</p> <p>6.Visinu troškova određuje svojom odlukom Ministar.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Način polaganja ispita</p> <p>Ispit se polaže pismeno i usmeno.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Organizovanje pismenog dela ispita</p> <p>1.Pismeni deo ispita polaže se iz krivičnog prava i građanskog u dva uzastopna dana.</p> <p>2.Zadatke za pismeni deo ispita priprema</p>
--	--	---

<p>anëtari i Komisionit për lëndën nga e cila mbahet provimi me shkrim përkatës.</p> <p>3.Përmes detyrave me shkrim kandidatit i vlerësohet aftësia e tij për përgatitjen e padive, përgjigjes në padi, aktakuzës, vendimit (aktgjykim ose aktvendim) apo mjetit juridik kundër vendimeve, etj.</p> <p>4. Në provim me shkrim mund të jepet një detyrë për të gjithë kandidatët, të cilët në të njëjtën kohë i nënshtrohen provimit me shkrim, por mund të caktohen edhe detyra të veçanta për më shumë kandidatë të një grupi.</p>	<p>drafted by the member of the Commission for the subject on which the written examination is entered.</p> <p>3.Through writing assignments, the candidates is assessed on his abilities in drafting claims, responses to claims, indictments, rulings (judgments or decisions) or the legal remedies against rulings, etc.</p> <p>4. In the written examination there may be one assignment for all candidates who undergo the written examination at the same time, but special assignments may also be assigned for more candidates of a group.</p>	<p>član komisije iz predmeta iz kojeg se polaže odnosni pismeni ispit.</p> <p>3.Preko pismenih zadataka ocenuje se sposobnost kandidata da pripremi tužbu, odgovor na tužbu, optužnicu, odluku (presudu ili rešenje) ili pravni lek protiv odluke, itd.</p> <p>4.Na pismenom delu ispita može se dati isti zadatak za sve kandidate, koji u isto vreme polažu pismeni deo ispita, ali mogu da se odrede i posebni zadaci za više kandidata iz jedne grupe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Identifikimi i kandidatëve</p> <p>1.Kandidati që i nënshtrohet provimit duhet të kenë me vete një dokument identifikimi me fotografi.</p> <p>2.Testit te kandidatit që i nënshtrohet provimit do të merr një kod të identifikimit që do të përdoret gjatë provimit me shkrim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Identification of candidates</p> <p>1.The candidate undergoing the examination should have with him an identification document with a photograph.</p> <p>2.The test the candidate undergoing the examination receives an identification code which will be used during the written examination.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Utvrdivanje identiteta kandidata</p> <p>1.Kandidat koji pristupa polaganju ispita mora da nosi sa sobom lični identifikacioni dokument sa slikom.</p> <p>2.Test kandidat koji pristupa polaganju ispita dobiće identifikacionu šifru koju će da koristi u toku pismenog dela ispita.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 13 Procedura gjatë provimit me shkrim</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Procedure during the written Examination</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Postupak u toku pismenog dela ispita</p>
<p>1.Kandidatëve u dorëzohet detyra dhe njoftohen me dispozitat ligjore në fuqi që duhet t'i respektojnë gjatë kohës së hartimit të detyrës.</p> <p>2.Provimi me shkrim mbahet për të gjithë kandidatët në kohëzgjatje prej katër (4) orësh prej kohës së kumtimit të detyrës. Nëse kandidati nuk e dorëzon detyrën brenda kohës së caktuar, ose gjatë kohëzgjatjes së provimit heq dorë nga hartimi i detyrës, konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.</p> <p>3. Në pjesën e provimit me shkrim merr pjesë anëtari i Komisionit që pyet lëndën e cila mbahet me shkrim, Sekretari i komisionit dhe nënpunësit civil të Ministrisë së Drejtësisë të angazhuar për mbështetje administrative/teknike e komisionit.</p> <p>4.Provimi me shkrim punohet në mënyrë anonime me kod identifikues të caktuar nga Sekretari.</p> <p>5.Gjatë kohëzgjatjes së provimit me shkrim</p>	<p>1. The candidates receive the assignment and are notified of the applicable legal provisions that are to be followed as they write down the assignment.</p> <p>2.The written examination is held for all candidates within for (4) hours from the time when the assignment is handed. The candidate is considered not to have passed the examination in cases when the candidate does not hand over the assignment within the set deadline, or when he withdraws from writing the assignment during the course of the examination.</p> <p>3. Part of the written examination is the member of the Commission, entitled to evaluate written examination from its filed of expertise, Commission's Secretary and the civil servants of the Ministry of Justice appointed in administrative/technical support of the commission.</p> <p>4.The written examination is written in an anonymous manner with an identification code assigned by the secretary.</p> <p>5.During the course of the written</p>	<p>1.Kandidatima se zadaju zadaci i obaveštavaju se o zakonskim odredbama važećih zakona koje moraju da poštuju u toku pisanja zadataka.</p> <p>2. Pismeni deo ispita održava se za sve kandidate u trajanju od qetri (4) sati od trenutka saopštavanja zadataka. Ako kandidat ne preda svoj rad u postavljenom roku, ili ako u toku ispita odustane od rešavanja zadataka, smatra se da nijepoložio ispit.</p> <p>3.Deo pismenog ispita je član Komisije, koji je zaduzen da ocenjuje pismeni ispit iz svoje stručne oblasti, sekretar Komisije i civilni službenici Ministarstva pravde angazovani u administrativnoj/tehničkoj podršci komisije.</p> <p>4.Pismeni deo ispita radi se anonimno i pod identifikacionom šifrom koju je odredilo sekretar.</p> <p>5.Za vreme trajanja pismenog dela ispita</p>

<p>kandidatit nuk i lejohet të kontaktojë me persona tjerë (të përdorë telefonin mobil) apo të braktisë ambientin në të cilin mbahet provimi, me përjashtim të rasteve të arsyeshme.</p> <p>6.Me rastin e hartimit të detyrës me shkrim, kandidati mund të shërbehet vetëm me tekstet e ligjeve pa komentare.</p> <p>7.Kandidati i cili e dorëzon detyrën duhet të dalë nga salla e mbajtjes së provimit.</p>	<p>examination, the candidate is not allowed to contact with other persons (use the cellular phone) or to abandon the setting where the examination is taking place, with the exception of reasonable cases.</p> <p>6.While answering the written assignment, the candidate can only be served with texts of legal provisions without commentary.</p> <p>7.The candidate handing over the assignments should leave the room where examination is taking place.</p>	<p>kandidatu nije dozvoljeno da kontaktira sa drugima (da koristi mobilni telefon) niti da napusti okruženje u kojima se održava ispit, osim u opravdanim slučajevima.</p> <p>6.Prilikom pisanja pismenih zadataka, kandidat može da se služi samo zakonskim tekstovima bez komentara.</p> <p>7.Kandidat koji preda svoj rad treba da izađe iz sale u kojoj se održava ispit.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Vlerësimi i provimit me shkrim</p> <p>1. Detyra me shkrim kontrollohet nga anëtari i Komisionit i cili pyet lëndën e cila jepet me shkrim.</p> <p>2.Pas marrjes së mendimit nga anëtari i komisionit i cili e ka kontrolluar detyrën me shkrim, Komisioni me shumicë votash miraton vendimin për suksesin e arritur në provimin me shkrim.</p> <p>3.Vlerësimi i suksesit të arritur në provimin me shkrim bëhet në pajtim me Nenin 18 të Ligjit.</p> <p>4.Provimi me shkrim vlerësohet me “kalon”</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Assessment of written examination</p> <p>1. The written assignment is reviewed by the member of the Commission who assesses the particular subject responded for in the written assignment.</p> <p>2.Following the reception of the opinion from the member of the commission who has reviewed the written assignment, the Commission, by a majority vote, approves the decision for the success attained at the written examination.</p> <p>3.The assessment of the attained success at the written examination is performed in compliance with Article 18 of the Law.</p> <p>4.The written examination is assessed with</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Ocenjivanje pismenog dela ispita</p> <p>1. Pisane radove kontroliše član komisije koji usmeno ispituje predmete koji se polažu pismeno.</p> <p>2.Nakon dobijanja mišljenja člana komisije koji je kontrolisao pismeni rad, komisija većinom glasova donosi odluku o uspehu postignutom na pismenom delu ispita.</p> <p>3.Ocena uspeha postignutog na pismenom delu ispita vrši se u skladu sa članom 18. Zakona.</p> <p>4.Pismeni deo ispita ocenjuje se rečima</p>

<p>ose “nuk kalon”.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Shpallja e rezultateve të provimit me shkrim</p> <p>1.Komisioni në përbërjen e tij të plotë shpallë listën e kandidatëve që e kanë kaluar provimin jo me larg se pesëmbëdhjetë ditë (15) nga data e mbajtjes së provimit me shkrim.</p> <p>2.Rezultatet e provimit me shkrim nga paragrafi 1 i keti neni publikohen në ueb faqen zyrtare të Ministrisë me numër të protokollit.</p>	<p>"pass" or "does not pass".</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Announcing results of written examination</p> <p>1. The commission in its full composition announces the list of candidates who have passed the exam no later than fifteen days (15) from the date of holding the written exam.</p> <p>2.Written examination results are published on the official website of the Ministry with protocol number.</p>	<p>„položio“ ili „nije položio“.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Objavlivanje rezultata pismenog dela ispita</p> <p>1. Komisija u punom sastavu objavljuje listu kandidata koji su položili ispit najkasnije u roku od petnaest (15) dana od dana održavanja pismenog ispita.</p> <p>2.Rezultati pismenog dela ispita objavljuju se na zvaničnoj internet stranici Ministarstva sa brojem protokola.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Organizimi i provimit me gojë</p> <p>1. Kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e provimit me shkrim kanë të drejtë të hyjnë në provim me gojë.</p> <p>2. Për kandidatët të cilët e kanë kaluar pjesën e provimit me shkrim nga drejta penale dhe e drejta civile, Ministria në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit cakton vendin dhe kohën e mbajtjes së provimit me gojë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Organizing the oral examination</p> <p>1. Candidates who pass the written examination part are entitled to enter the oral examination.</p> <p>2.For candidates who have passed the written examination part from criminal and civil law, the Ministry, in collaboration with the Chairman of the Commission, determines the venue and time of organizing the oral examination.</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Organizovanje usmenog dela ispita</p> <p>1. Kandidati koji su položili pismeni deo ispita imaju pravo da pristupe polaganju usmenog dela ispita.</p> <p>2. Za kandidate koji su položili pismeni deo ispita iz predmeta krivično i građansko pravo, Ministarstvo u saradnji sa predsednikom komisije određuje mesto i vreme održavanja usmenog dela ispita.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 17 Procedura e Provimit me Gojë</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Procedure of Oral Examination</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Postupak za usmeni deo ispita</p>
<p>1.Pas komunikimit të rezultateve të provimit me shkrim, kandidatët vlerësohen me gojë në lëndët e përcaktuara në nenin 21 të Ligjit.</p> <p>2.Provimi me gojë është publik dhe mbahet para Komisionit në përbërjen e tij të plotë.</p> <p>3.Nëse kandidati tërhiqet nga pjesa e provimit me gojë ose nuk paraqitet pa arsye në provim në kohën e caktuar, ai konsiderohet se nuk e kalon provimin.</p> <p>4.Për të mbajtur rregull, Komisioni mund të kufizojë numrin e personave që dëshirojnë të jenë të pranishëm gjatë provimit.</p> <p>5.Kandidati i cili nuk kalon pjesën e provimit me gojë, mbetet në riprovim.</p> <p>6.Për pamundësinë e pjesëmarrjes së ndonjë kandidati në provim me gojë, për rastet e arsyeshme të cilat i vlerëson Komisioni, provimi me shkrim i kandidatit mbetet i vlefshëm deri në afatin e provimit tjetër.</p>	<p>1.Following the communication of written examination results, candidates are orally assessed on the subjects determined by Article 21 of the Law.</p> <p>2.The oral examination is public and is held before the Commission on its full composition.</p> <p>3.If the candidate withdraws from the oral examination part or does not show up at the specified time without a justification, he is considered to have failed the examination.</p> <p>4.In maintain order, the Commission may limit the number of persons who desire to be present during the examination.</p> <p>5.A candidate who does not pass the oral examination part is subject to re-entering the examination.</p> <p>6.Concerning the inability of a candidate in attending the oral examination for cases deemed reasonable by the Commission, the written examination of the candidate remains valid until the next examination term.</p>	<p>1.Posle saopštavanja rezultata pismenog dela ispita, kandidati se ocenjuju usmeno iz predmeta utvrđenih u članu 21 Zakona.</p> <p>2.Usmeno polaganje ispita je javno i održava se pred komisijom u punom sastavu.</p> <p>3 Ako se kandidat povuče sa usmenog dela ispita ili ako se na ispitu ne pojavi u određeno vreme bez opravdanja, smatraće se da nije položio ispit.</p> <p>4.Radi održavanja reda, Komisija može da ograniči broj lica koja žele da prisustvuju polaganju ispita.</p> <p>5.Kandidat koji ne položi usmeni deo ispita ostaje na popravnom ispit.</p> <p>6.U slučaju da neki kandidat nije u mogućnosti da učestvuje na usmenom polaganju ispita iz razloga koje komisija oceni kao opravdane, pismeni deo ispita koji je kandidat položio važi do narednog ispitnog roka.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 18 Maksimumi i pikëve të dhënies së provimit</p> <p>Kandidati do të konsiderohet se e ka kaluar provimin nëse arrin pikët e përcaktuara në nenin 21 të Ligjit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Maximum points of examination</p> <p>The candidate is considered to have passed the examination if he collects points as determined in Article 21 of the Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Maksimalni broj bodova na polaganju ispita</p> <p>Smatraće se da je kandidat položio ispit ako ostvari broj bodova propisan u članu 21. Zakona.</p>
